



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:115808
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05697462

KPPP.nr.2011/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit TEB sh.a, me seli në Prishtinë, adresa Preoc, pn Graçanicë, Magjistrala Prishtinë-Ferizaj, kundër debitorëve 1.) “I & B – Group SH.P.K.” me NUI:810142430, me seli në Mitrovicë, K.D.Q. Tregtare 48-1, 2.) BAKII SH.P.K. me NRB:810062472, me seli në Mitrovicë Rr. “Mitrovicë Vlora”, 3.) N.H. me adresë në Mitrovicë Rr. “...” dhe 4.) “Isa Dekor” me NUI:810566961, përfaqësuar nga I.H., me seli në Mitrovicë Rr. “Vlora”, Shipolë, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit i përfaqëson Agron Krasniqi, avokat nga Prishtina Rr. “Tirana”, Objekti i Prime Group, Hyrja D/8, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.464/22 të datës 19.04.2022, të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorëve 1.) “I & B – Group SH.P.K.” me NUI:810142430, 2.) 2.) BAKII SH.P.K. me NRB:810062472, 3.) N.H. dhe 4.) “Isa Dekor” me NUI:810566961, përfaqësuar nga I.H., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.464/22 të datës 19.04.2022, të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.464/22 i datës 19.04.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa.

A r s y e t i m

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Atip Mustafa, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbartimor me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Marrëveshjes mbi Kredinë nr.82304 të datës 30.10.2020, Marrëveshja mbi pengun, Konfirmimin

e regjistrimit R-20201102-112 të datës 02.11.2020, duke detyruar debitorët t'ia paguajnë borxhin e mbetur në shumë prej 9,971.24 €, ka urdhëruar të gjitha Institucionet Financiar se në rast se ka mjete atëherë të transferohen përmes llogarisë së veçantë të organit përmbarues me qëllim të përmbylljes së obligimit. Në rast të mos realizimit me anë të llogarive bankare, të sekuestrohet kolaterali i debitorëve sipas kontratës së pengut dhe të njëjtat ti dorëzohen kreditorit për ti shitur, që nga çmimi i shitblerjes të përmbushet obligimi i debitorëve.

Kundër urdhrin përmbarimor në afatin e paraparë ligjor prapësim ka ushtruar i autorizuari i debitorëve, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, ndër të tjerash kanë theksuar se procedura përmbarimore nuk mund të iniciohet në bazë të nenit 21 të Ligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme. Ka shtuar se në propozim është kërkuar që të bëhet sekuestrimi kolateralit pa dëgjimin e debitorit në këtë rast penglënësve por që një gjë e tillë është i pa pranueshëm dhe nuk plotësohen kërkesat për shkak se debitorët ushtrojnë të drejtën e tyre për mjete juridike. Më tutje ka theksuar se debitori kryesor por edhe pjesëmarrësit në kredi do të përgjigjen për borxhet e arritura të cilat do ti paguaj me kohë për një kohë tejet të shkurtër dhe do të kalojnë në këstin e rregullt i cili do të bëhet konform borxhit të arritur i cili do të duhej të dëshmohej nga ana e kreditorit. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorëve ta aprovoj si të bazuar dhe urdhri përmbarimor të anulohet dhe të obligohet kreditori në kompensimin e shpenzimeve për përpilimin e prapësimin.

Kreditori në përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorëve, ndër të tjerash ka theksuar se prapësimi i debitorëve nuk është i bazuar në asnjërin nga paragrafët e nenit 71 dhe si i tillë nuk ka bazë ligjore. Ka shtuar se shihet qartë se debitori qëllimin kryesor e ka keqpërdorimin e të drejtave procedurale me qëllim të prolongimit të procedurës së përmbarimit e rrjedhimisht realizimit të kërkesës së kreditorit pasi që në shkresat e lëndës janë të bashkangjitura të gjitha shkresat në bazë të cilave është iniciuar procedura përmbarimore duke filluar nga kontrata e pengut, kredisë, certifikata e regjistrimit të pengut dhe lista e pengut. I ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorëve dhe urdhri për përmbarim të vërtetohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorëve është në tërësi i pa bazuar, andaj, të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarrues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5 par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbarruese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet se dokument përmbarrues paraqet *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbarrjes së detyrimit”*.

Gjykata duke vlerësuar Marrëveshjen mbi Kredinë nr.82304 të datës 30.10.2020, Marrëveshja mbi pengun, gjeti se të njëjtat janë dorëzuar në kopje të vërtetuara, janë hartuar në formën e paraparë me ligj, dhe të njëjtat janë regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20201102-112 të datës 02.11.2020, dhe si të tilla përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22, pika 1.7 dhe 1.7 a, lidhur me nenin 27 të LPP-së, për të qenë dokumentet të përmbarrueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarrim.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorëve të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarrimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarrimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2011/22, datë 16.05.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.